

## Marenglen VERLI

### KONFERENCA E PAQES E PARISIT DHE QËNDRIMET E DIASPORËS DHE KOMITETIT “MKK” PËR ÇËSHTJEN E KOSOVËS

#### **Abstrakt:**

*Më 24 janar 1924, Turhan Pashë Përmeti dhe anëtarët e qeverisë së Durrësit, hartuan programin qeveritar që do të ishte orientim për veprimtarinë e delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Në të thuhej se objekti ishte “mbrojtja jashtë shtetit e pavarësisë dhe e tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe e të drejtave sovrane të popullit shqiptar brenda kufijve etnikë”. Në memorandumet që iu paraqitën më 15 shkurt 1919 Konferencës (ai mban datën 12 shkurt), më 24 shkurt, të cilët ishin pothuajse të njëjtë, u trajtuan tri çështje kryesore: së pari, rinjohja dhe garantimi i pavarësisë, tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe respektimi i të drejtave sovrane të popullit shqiptar, të përcaktuara më 1913 në Londër; së dyti, të korrigjoheshin kufijtë dhe të përfshiheshin në Shqipëri territoret shqiptare të copëtuara në favor të fqinjëve me vendimet e Kongresit të Berlinit (1878) dhe Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913); së treti, të hidheshin poshtë pretendimet e fqinjëve në Konferencë, për të aneksuar territore të tjera shqiptare, brenda kufijve të 1913-ës. Dihet se në rrethanat e kohës as gjykimi ndërkombëtar për problemet që trajtonte Konferenca, përfshi edhe problemin shqiptar, nuk ishte i paanshëm dhe as qëndrimi i delegacionit shqiptar nuk ishte i njësuar dhe i padiferencuar ndaj tre fqinjëve të Shqipërisë. Në Paris, përveç delegacionit zyrtar të qeverisë së Durrësit (10 vetë) deri në fillim të prillit, u shtuan edhe përfaqësuesit e diasporës shqiptare, që aso kohe ishte shumë më e zhvilluar se popullsia në Shqipëri nga ana kulturore dhe në një gjendje të mirë ekonomike. Përfaqësuesit e diasporës shqiptare në Turqi, ShBA dhe Rumani, por edhe të Komitetit “MKK” kishin pasur rol aktiv në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare gjatë Rilindjes dhe në vitet pas Shpalljes së Pavarësisë. Dërgimi i tyre në Paris tregonte për shqetësimin e madh që ekzistonte në diasporë, por edhe në KMKK për të ardhmen e vendit dhe rëndësinë e madhe që i jepej prej tyre luftës diplomatike për të mbrojtur interesat e kombit shqiptar. Por, situata nuk ofronte asgjë të mirë për shqiptarët. Diplomati amerikan Kliv Dei pas takimit me Turhan Pashën dhe Luigj Gurakuqin njoftonte presidentin Uillson se ata*

*kishin ngritur pretendime etnike të papranueshme. Ai sugjeronte se “është më mirë që Shqipëria të mbajë atë që kishte më 1913 se sa të rrezikojë të humbasë pjesë të territorit të saj duke u përpjekur të marrë më shumë”. Në këtë punim do të argumentohet qëndrimi i diasporës dhe elitës së Kosovës, të emigruar në Shqipëri dhe të organizuar në Komitetin “MKK”, për çështjen e Kosovës në rrethanat ndërkombëtare të viteve 1919-1920 dhe veçanërisht në rrjedhën e zhvillimeve të Konferencës së Paqes në Paris.*

**Fjalë kyçe:** Konferenca e Paqes në Paris, çështja e Kosovës, diaspora shqiptare, Komiteti “MKK”, diplomacia shqiptare.

Më 24 janar 1919, Turhan Pashë Përmeti, i ardhur nga diaspora, dhe anëtarët e qeverisë së Durrësit, hartuan programin qeveritar që do të ishte orientim për veprimtarinë e delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Në të thuhej se objekti ishte “mbrojtja jashtë shtetit e pavarësisë dhe e tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe e të drejtave sovrane të popullit shqiptar brenda kufijve etnikë.”<sup>1</sup>

Në memorandumet që iu paraqitën më 15 shkurt 1919 Konferencës (ai mban datën 12 shkurt) dhe më 24 shkurt, të cilët ishin pothuajse të njëjtë, u trajtuan tri çështje kryesore: *së pari*, rinjohja dhe garantimi i pavarësisë e tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe respektimi i të drejtave sovrane të popullit shqiptar, të përcaktuara më 1913 në Londër; *së dyti*, të korrigjoheshin kufijtë dhe të përfshiheshin në Shqipëri territoret shqiptare të copëtuara në favor të fqinjëve me vendimet e Kongresit të Berlinit (1878) dhe Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913); *së treti*, të hidheshin poshtë pretendimet e fqinjëve në Konferencë, për të aneksuar territore të tjera shqiptare, brenda kufijve të 1913-ës.

Dihet se në rrethanat e kohës as gjykimi ndërkombëtar për problemet që trajtonte Konferenca, përfshi edhe problemin shqiptar, nuk ishte i paanshëm dhe as qëndrimi i delegacionit shqiptar nuk ishte i njësuar dhe i padiferencuar ndaj tre fqinjëve të Shqipërisë.

Në Paris, përveç delegacionit zyrtar të qeverisë së Durrësit (10 vetë), shumica e të cilëve edhe pas vitit 1912 ishin pjesë e mërgatës ose diasporës shqiptare, deri në fillim të prillit, u shtuan edhe përfaqësuesit e kolonive

<sup>1</sup> *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar 1918-1920* (Përmbledhje dokumentesh), botim i Institutit të Historisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shtetit, Vëll.II, 1976, f. 107-109; Amadeo Giannini, *L'Albania dall'indipendenza all'unione con l'Italia (1913-1939)*, Milano, 1930, f. 233-235.

shqiptare të diasporës, që aso kohe ishte shumë më e zhvilluar se popullsia në Shqipëri nga ana arsimore, kulturore dhe nga gjendja ekonomike.

Përfaqësuesit e diasporës shqiptare, përkatësisht të kolonive apo ngulimeve shqiptare në Turqi, ShBA dhe Rumani, por dhe shumë personalitete të Komitetit “MKK”, që pas 1912-1913-ës, dhe pas 1918-ës, mund të konsiderohen edhe si përfaqësues të mërgatës me origjinë nga Kosova, kishin pasur rol aktiv në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare gjatë Rilindjes dhe në vitet pas Shpalljes së Pavarësisë. Dërgimi i tyre në Paris tregonte për shqetësimin e madh që ekzistonte në diasporë por edhe në KMKK për të ardhmen e vendit dhe rëndësinë e madhe që i jepej prej tyre luftës diplomatike për të mbrojtur interesat e kombit shqiptar. Ndërkohë, situata nuk ofronte asgjë të mirë për shqiptarët. Një nga ekspertët në radhët e delegacionit në konferencë, profesori amerikan Klajv Dej (Klive Day), pas takimit me Turhan Pashën dhe Luigj Gurakuqin njoftonte presidentin Uillson se atakishin ngritur pretendime etnike të papranueshme. Ai sugjeronte se “është më mirë që Shqipëria të mbajë atë që kishte më 1913 se sa të rrezikojë të humbasë pjesë të territorit të saj duke u përpjekur të marrë më shumë”<sup>2</sup>. Kurse një nga përfaqësuesit anglezë në Konferencë, Ajres Krou (Sir Eyres Krowe) shënoi anash memorandumit të delegacionit shqiptar të 24 shkurtit: “Nuk ia vlen as të lexohen”<sup>3</sup>.

Ndërkohë, ministri i Jashtëm i Francës, S. Pishon, do t’u deklaronte anëtarëve të delegacionit shqiptar: “Ajo që kanë fituar aleatët tanë në Luftën Ballkanike, nuk mund të cenohet. Të mos harroni se edhe serbët e grekët luftuan me ne së bashku kundër armiqve tanë”<sup>4</sup>.

Pretendimet e fqinjëve, aleatë të Antantës gjatë luftës, përkatësisht të Greqisë dhe shtetit SKS (Jugosllavisë), por edhe të Italisë, që shfaqej sikur ishte për ruajtjen e kufijve të 1913-ës, por që në fakt e donte Shqipërinë pa pjesëtarë, tregonin se rreziku shkonte jo vetëm në cungimin e mëtejshëm të kufijve, por edhe deri në asgjësimin e plotë të shtetit shqiptar dhe zhbërjen e gjithë arritjeve të viteve 1912-1913 të miratuara nga gjashtë Fuqitë e Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

---

<sup>2</sup> Informacion i K.Dei-t, dt. 22 maj 1919, cituar sipas Paskal Milos, *Politika e jashtme e Shqipërisë (1912-1939)*, Vëll.I, Tiranë: Toena, 2013, f. 390.

<sup>3</sup> N. Petsalis - Diomidis, *Greece at the Paris Peace Conference 1919*, Thesaloniki, 1978, f. 142-143, shënimi 8.

<sup>4</sup> *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë (AQSH)*, Fondi Shoq. Kult. Shqip. e Rumanisë, Dosja 1/9. Pohime konfidenciale të ministrit të Francës, S. Pishon, dhënë delegacionit shqiptar në Paris, tetor 1919.

Në këtë punim do të argumentohet qëndrimi i diasporës dhe elitës politike atdhetare të Kosovës, të emigruar në Shqipëri dhe të organizuar në Komitetin “MKK”, për çështjen e Kosovës në rrethanat ndërkombëtare të viteve 1919-1920 dhe veçanërisht në rrjedhën e zhvillimeve të Konferencës së Paqes në Paris.

Nga mesi i marsit 1919, delegacionit zyrtar të qeverisë së Durrësit në Paris, të përbërë fillimisht nga tre përfaqësues të diasporës, Turhan Pasha (dy herë kryeministër më 1914 dhe më 1918), Mehmet Konica (ministër më 1918 dhe më 1920 dhe me detyra të rëndësishme diplomatike më 1913, 1914, 1916, 1920-39) dhe Mihal Turtulli (ministër më 1914 dhe 1918, anëtar i Këshillit të Lartë më 1920) iu shtua edhe imzot Luigj Bumçi (të katër të caktuar si delegatë nga Kongresi i Durrësit, 25 dhjetor 1918). Imzot Bumçi shkoi atje bashkë me at Gjergj Fishtën, që do të kryente funksionin e sekretarit të Përgjithshëm të delegacionit. Në formatimin e vet të plotë, delegacioni do të kishte në përbërje edhe Myfit Libohovën dhe përfaqësuesit e mërgatës apo diasporës në periudha të ndryshme të jetës dhe pas vitit 1912, Mustafa Krujën, Mehdi Frashërin dhe Mit’hat Frashërin, pra 10 vetë.<sup>5</sup>

Në Paris mbërritën edhe përfaqësuesit e kolonive shqiptare jashtë vendit. Pas përfaqësisë së kolonisë shqiptare të Turqisë, të përbërë nga Halil Pashë Alizoti, Fuat Dibra, Mihal Shani Tepelena etj., në fillim të prillit, atje mbërriti nga ShBA, përfaqësuesja e “Partisë Politike”, Parashqevi Qiriazi së bashku me Mihal Gramenon. Pothuajse në të njëjtën kohë në Paris, arriti edhe një përfaqësi e dërguar nga shqiptarët e Rumanisë, e përbërë nga Pandeli Evangjeli (kryetar) dhe Ibrahim Temo e Pjetër Goxhomani (anëtarë). Përfaqësisë nga Rumania iu atashua princi Albert Gjika me origjinë të largët nga Shqipëria dhe pak më vonë edhe Dhimitër Berati<sup>6</sup>.

Këta përfaqësues, sikurse edhe delegatët e qeverisë së Durrësit të përmendur më sipër, kishin pasur, kush më pak e kush më shumë, rol aktiv në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare gjatë Rilindjes dhe në vitet pas Shpalljes së Pavarësisë. Dërgimi i tyre në Paris tregonte për shqetësimin e madh që ekzistonte gjithandej te shqiptarët e kolonive të diasporës, e veçanërisht te elita e tyre, për të ardhmen e Shqipërisë dhe njëherësh për rëndësinë e madhe që i jepnin luftës diplomatike në Konferencën e Paqes për këtë të ardhme.

<sup>5</sup> P. Milo, *Politika e jashtme...*, f. 394-395.

<sup>6</sup> *Historia e popullit shqiptar*, Vëll.III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 135; *Lufta e popullit shqiptar...*, vëll.I, dok. 267, f. 409. Delegatët e caktuar nga Kongresi i Durrësit ishin Turhan Pasha, Mehmet Konica, Luigj Bumçi, Mihal Turtulli dhe Mithat Frashëri.

Arritja në Paris e përfaqësuesve të sipërpërmendur ndodhi në një kohë kur divergjencat në gjirin e delegacionit qeveritar ishin thelluar.

Shkak ishte bërë debati për përcaktimin e rrugës më të përshtatshme që duhej ndjekur më tej në Konferencë për realizimin të paktën të programit minimal të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, d.m.th për ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe për mbrojtjen e tërësisë territoriale të shtetit shqiptar. Nuk u hoq dorë edhe nga programi maksimal, pra nga përfshirja në kufijtë e shtetit shqiptar të territoreve shqiptare, të mbetura jashtë kufijve të 1913-ës, porse u vlerësua se ky program në rrethanat e krijuara ishte i përealizueshëm me rrugë diplomatike.

Nga të katër Fuqitë e Mëdha, as Italia, që shfaqej si mike e shqiptarëve, nuk tregojë e gatshme të mbështeste kërkesat territoriale shqiptare ndaj Serbisë (shtetit SKS) dhe Greqisë (aleate të Antantës), pavarësisht se këto kërkesa mbështeteshin në parimin e kombësisë.

Divergjenca në radhët e delegacionit qeveritar në Paris në mbledhjen e 24-26 marsit, pati edhe lidhur me çështjen në se “jemi të zot të qeverisemi thjesht me mjetet e fuqitë tona, apo kemi nevojë për ndihmën e ndonjë shteti të huaj?”; së dyti, “cili do të ishte ai shtet, apo ajo Fuqi e Madhe, nga e cila duhej kërkuar ndihma?” A do të ishte ShBA, sikurse mendonin M. Konica e M. Turtulli, apo Italia, sikurse mendonin Turhan Pasha e Luigj Bumçi së bashku me Mustafa Krujën e Luigj Gurakuqin?<sup>7</sup>

Anëtarët e delegacionit u pajtuan me idenë se periudha 1913-1918 kishte treguar se “ndihma” e huaj ishte e nevojshme. Gjendja e keqe ekonomike e vendit, Traktati i Fshehtë të Londrës, i vitit 1915, dy kryengritjet antikombëtare të viteve 1914-1915, tregonin se duhej mbështetja e një fuqie të madhe. Fraksioni M. Konica-M. Turtulli, në një letër dërguar Turhan Pashës (kryetarit të delegacionit) më 14 prill 1919, theksonte se Italia jo vetëm nuk mund ta mbronte Shqipërinë, “por përkundrazi, me dëshirën e saj për ta shndërruar Vlorën dhe hinterlandin e saj në një tokë italiane, ishte bërë shkaktarja kryesore e shkatërrimit tonë kombëtar” dhe ajo rrugë “do ta çonte vendin tonë drejt katastrofës”<sup>8</sup>.

Veprimi i pavarur nga njeri-tjetri i dy fraksioneve, ndodhi haptazi më 14 prill kur diskutimi i “çështjes së Adriatikut” ishte në një rën prej kulmeve të tij: atë ditë të dy fraksionet i dërguan Konferencës së Paqes nga një notë të

<sup>7</sup> AQSH, Fondi MPJ, dosja 322. Procesverbal i mbledhjes së delegacionit shqiptar në Paris, 26 mars 1919; shih edhe *Lufta e popullit shqiptar...*, vëll.I, dok. 91, f. 152.

<sup>8</sup> AQSH, Fondi MPJ, dosja 323. Letër e M.Turtullit dhe M.Konicës dërguar Turhan Pashës, dt. 14 prill 1919; Shih edhe *Lufta e popullit shqiptar...*, vëll.I, dok. 102, f. 161-162.

veçantë. Notës së fraksionit Konica-Turtulli, iu bashkua edhe Mit'hat Frashëri, që ndërkohë ndodhej në Zvicër.

Memorandumi Turtulli-Konica-Frashëri u nënshkrua edhe nga përfaqësuesit e diasporës shqiptare të Turqisë, ShBA-së dhe Rumanisë (gjithsej 11 vetë) dhe më 15 prill iu përcoll kryetarit të Konferencës së Paqes<sup>9</sup>. Memorandumi i sipërpërmendur dhe ai i grupit tjetër, pra i shumicës së delegacionit qeveritar, kishin në fakt disa kërkesa të përbashkëta, përveç dallimit lidhur me vlerësimin e politikës italiane ndaj Shqipërisë. Në të dy memorandumet kërkohej respektimi i pavarësisë dhe i tërësisë tokësore të shtetit shqiptar. Nuk mungonte as kërkesa për rishikimin e kufijve të këtij shteti për t'u përfshirë brenda tij trevat shqiptare të lëna më parë jashtë kufijve. E përbashkët ishte gjithashtu se të dy grupet qoftë ai me prirje anglosaksone, e aq më tepër ai me qëndrim proitalian pajtoheshin me "mandatin" apo "asistencën" e një Fuqie të Madhe për momentin, përkatësisht ShBA-së ose Italisë, duke mos e konsideruar oportune kërkesën për pavarësi të plotë.<sup>10</sup>

Në situatën e sipërpërmendur (diskutimi i "çështjes së Adriatikut" në konferencë) u vunë në lëvizje jo vetëm përfaqësuesit shqiptarë në Paris, por edhe qendrat e ndryshme shqiptare që ndodheshin jashtë vendit. Ndër to filloi të dallohej grupi shqiptar i Lozanës (Zvicër) i përbërë nga veprimtarë aktivë, si mërgimtarët Pandeli Cale, Sotir Kolea, Rasih Dino, Hilmi Këlcyra etj. I shqetësuar nga politika e Italisë, ky grup e bombardoi me mesazhe telegrafike Konferencën e Paqes. Në mesazhin e 22 prillit 1919, që kundërshtonte pretendimin italian mbi Vlorën, kërkohej që për arsye të përbërjes së popullsisë dhe për arsye strategjike Vlorë duhet t'i përkiste Shqipërisë<sup>11</sup>.

Në kundërshtim të argumentit italian nevojën për Vlorën për arsye "sigurie", theksohej se rreziku austro-hungarez tani nuk ekzistonte dhe se "asnjënjësia" e rikonfirmuar e Shqipërisë nga Lidhja e Kombeve ishte garanci e mjaftueshme. Kishte dhe argumente të tjera pse Vlorë duhej të ishte e Shqipërisë, që shteti shqiptar "të ketë jetë të gjatë."<sup>12</sup>

Protesta të ngjashme u përcollën edhe nga komitetet shqiptare të ShBA-së, Kanadasë dhe Zvicrës, dt. 21 prill 1919<sup>13</sup>. Edhe këta përfaqësues të diasporës,

<sup>9</sup> *AQSH*, Fondi MPJ, dosja 203. Memorandumi i datës 15 prill; shih edhe *Lufta e popullit shqiptar...*, vëll.I, dok. 105, f. 166-168.

<sup>10</sup> *Po aty*.

<sup>11</sup> *L'Albanie*, Lausanne (Zvicër), 30.9.1919, f. 118-119; shih edhe *Lufta e popullit shqiptar...*, vëll.I, dok.113, f. 176.

<sup>12</sup> *Po aty*.

<sup>13</sup> *AQSH*, Fondi MPJ, dosja 17 (1919), f. 44.

sikurse fraksioni Turtulli-Konica besonin në ShBA dhe presidenti Uillson do t'u qëndronin "parimeve" të shpallura dhe, sikurse po vepronin duke mos i bërë lëshime Italisë në Fiume e Dalmaci, nuk do të pranonin t'i bënin asaj as për Vlorën në Shqipëri.<sup>14</sup>

Pas kërkesës së 15 prillit, që ShBA-ja të pranonin të udhëhiqnin Shqipërinë në "hapat e saj të parë në rrugën e përparimit dhe të qytetërimit", përfaqësuesit e kolonive shqiptare në Paris, por edhe qindra të tjera shqiptare jashtë Shqipërisë, më 29 prill e përsëritën kërkesën e 15 prillit si dhe i dërguan përgëzime presidentit Uillson për qëndrimin e tij parimor<sup>15</sup>. Por të gjithë u zhgënjyen kur në fund të prillit, ose në ditët e para të majit, shtypi i huaj botoi memorandumun amerikan të 14 prillit, në bazë të të cilit ShBA-ja pranonin t'i njihnin Italisë, Vlorën.

Shqetësimi ishte i madh por edhe reagimi i shpejtë. Në letrat dhe protestat që iu dërguan Uillsonit, qysh prej 1 majit, vihej në dukje se qëndrimi amerikan për Vlorën ishte në kundërshtim jo vetëm me "parimet e shpallura", por edhe "me tërë çështjen e drejtësisë njerëzore" dhe "katastrofë" për shtetin e vogël e të varfër shqiptar<sup>16</sup>. Reagimi ishte në unison nga i gjithë delegacioni qeveritar në Paris si dhe nga të gjithë përfaqësuesit e diasporës.<sup>17</sup> Gjithsesi, reagimet e palës shqiptare nuk patën ndonjë ndikim në Konferencën e Paqes. Pas Vlorës po vinte radha për të miratuar protektoratin apo mandatin italian mbi Shqipërinë, që logjikisht u shtronte rrugën kërkesave territoriale të Greqisë dhe Mbretërisë SKS në jug në veri të Shqipërisë së pranuar më 1913<sup>18</sup>.

Përballë rrezikut në rritje, që e nxirrte tërësisht nga agjenda e përfaqësuesve shqiptarë në Paris, çështjen e rikthimit të Kosovës dhe viseve të tjera të copëtuara brenda shtetit shqiptar, fraksioni Konica - Turtulli dhe përfaqësuesit e diasporës, trokitën fort tani edhe në dyert e delegacioneve të Britanisë së Madhe dhe të Francës.<sup>19</sup> Sigurisht trokitej në derë të mbyllur te ata

<sup>14</sup> Adriatikus, *La question Adriatique Recueil de documents officiels*, Paris: 1920, f. 48-51.

<sup>15</sup> *AQSH*, Fondi MPJ, dos. 9 (1919), fl. 184-185 dhe 8.10, fl. 176-177, dt. 29.04.1919; *po aty*, dos. 17 (1919), f. 44.

<sup>16</sup> *Adriatik Reviv*, qershor 1919, f. 291-292, 392-394; shih edhe gazeta *Dielli*, 2.05.1919.

<sup>17</sup> *AQSH*, Fondi MPJ, dos.8. Letër e delegacioneve të kolonive shqiptare të ndodhura në Paris, dërguar më 5 maj 1919 presidentit Uillson; *Dielli*, Boston Mass, 3.05.1919; *Albania - Shqipëria*, Worcester, nr. 56, dt. 15.05.1919, f. 1; *Lufta e popullit shqiptar...*, dok. 135, f. 204-205. Notë e delegacionit shqiptar në Paris, dt. 8 maj 1919 dërguar Uillsonit.

<sup>18</sup> Muin Çami, Marenglen Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes (1919-1920)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2015, f. 207.

<sup>19</sup> *AQSH*, Fondi MPJ, dos. 9 (1919), dt. 12.05.1919, f. 205-206 dhe 17.06.1919, f. 221-224, dos. 10 (1919), fl.218.

që kishin miratuar Traktatin e Fshehtë të Londrës më 1915. Një qëndrim i tillë dihej, por kjo nuk e pasivizoi pjesën e delegacionit shqiptar antiitalian dhe përfaqësuesit e diasporës për të këmbëngulur deri në fund kundër aneksimit të Vlorës dhe protektoratit mbi shtetin shqiptar. Madje, veprimtaria u zgjerua edhe në një drejtim tjetër. Grupi Konica-Turtulli dhe përfaqësuesit e diasporës morën takime dhe u dërguan letra miqve të Shqipërisë dhe personaliteteve të ndryshme të huaj, që mund të ndërhyjnë për të shmangur padrejtësitë që vijonin t'i bëheshin këtij vendi.<sup>20</sup>

Reagimi i përfaqësuesve shqiptarë në Paris u bë më i shpeshtë në gjysmën e dytë të vitit 1919. Madje, ata arritën të bashkoheshin dhe dolën në një front të përbashkët përpara Konferencës së Paqes. Në këtë bashkim luajti rol zhvillimi i ngjarjeve në Paris në dëm të çështjes shqiptare. Marrëveshja Titoni - Venizellos e 29 korrikut që ringjallte Traktatin e Fshehtë të Londrës ishte një kampanë alarmi. Dëshira për bashkim gjendet në ditarin e Parashqevi Qiriazit dhe në korrespondencën e dëndur të kësaj përfaqësueseje të denjë të diasporës, që ajo i përcillte Partisë Politike Kombëtare në ShBA (që e kishte deleguar në Paris). Ajo informonte ndër të tjerë për marrëdhëniet e shqiptarëve në Paris dhe për përpjekjet e saj dhe të përfaqësuesve të diasporës për t'i dhënë fund përçarjes, që kishte sjellë shqetësime e reagime si në Shqipëri edhe në kolonitë shqiptare jashtë.<sup>21</sup>

Sidoqoftë, largimi në fund të qershorit nga drejtimi i delegacionit, i Turhan Pashës, njëherësh me nxjerrjen jashtë të delegacionit qeveritar të fraksionit F. Konica-M. Turtulli, që bashkë me përfaqësuesit e diasporës kishin kundërshtuar ndërhyrjen e Italisë në Shqipëri, kishte sjellë shumë paqartësi dhe mosbesim te shqiptarët, se konferenca nuk do të humbte besimin se delegacioni i Shqipërisë përfaqësonte qëndrimin e kombit shqiptar<sup>22</sup>.

Madje, që kur nisën divergjencat politike midis anëtarëve të delegacionit qeveritar, në mars-prill, Komiteti MKK dërgoi në Paris, anëtarin e tij Sejfi Vllamasin, për të parë situatën dhe për të raportuar rreth saj.<sup>23</sup> Gati në të njëjtën kohë dhe po për këtë qëllim u dërgua nga kolonia shqiptare e Turqisë, Sulejman Delvina. Ky përfaqësues i diasporës, disa muaj më vonë, në janar

<sup>20</sup> *AMAE*, Europe 1918-1919, Albania, nr.29, f. 7-8; *AQSH*, Fondi MPJ, dos.9 (1919), fl. 199-201 dhe dos.10 (1919), f. 192-193, dt. 12.05.1919; gazeta *Populli*, Shkodër, nr. 22, 20 nëntor 1919, f. 2.

<sup>21</sup> *AQSH*, Fondi P. Qiriazit, dos. 2. Ditari. Po ashtu letërkëmbini në fondin K. Dako.

<sup>22</sup> M. Çami, M. Verli, *Shqipëria në Konferencën e Paqes...*, f. 294.

<sup>23</sup> Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri, 1897-1942* (Kujtime dhe vlerësime historike) përgatiti për botim Marenglen Verli, Tiranë, 1995, f. 162-166.

1920, do të zgjidhej nga Kongresi i Lushnjës, kryeministër i Shqipërisë. Ai kishte mision të veçantë në Paris: kishte të drejtë të bënte edhe ndryshime ndër përfaqësuesit e diasporës shqiptare të Turqisë, në qoftë se konstatonte se ndonjëri ndiqte “një politikë të kundërt me interesat e vendit.”<sup>24</sup>

Për të gjetur rrugën e bashkimit u angazhuan edhe dy organizatat shqiptare të diasporës në ShBA, përkatësisht “Vatra” dhe “Partia Politike Kombëtare”, të cilat ushtruan influencën e tyre të konsiderueshme përmes rekomandimeve e porosive të dërguara<sup>25</sup>. Sidoqoftë, duhet thënë se, për bashkimin e përfaqësuesve shqiptarë në Paris, rol parësor pati dështimi i përpjekjeve të të dy grupeve të delegacionit qeveritar, si atyre që shpresonin të arrinin një marrëveshje “të arsyeshme me Italinë, edhe të atyre që besonin se ShBA-ja kishte forcën absolute për të kundërshtuar pretendimet e fqinjëve dhe për të iniciuar vendime në përkrahje të aspiratave të shqiptarëve. Pasi mori detyrën e kryetarit të delegacionit qeveritar imzot Luigj Bumçi, ndërmoi një hap që e kishte refuzuar më parë Turhan Pasha.

Më 24 korrik, ai ftoi të gjithë përfaqësuesit e diasporës shqiptare, apo të kolonive, të bashkëpunonin me delegacionin e ri qeveritar, takime që do të organizoheshin dy herë në javë. “Këtë e bëj, theksonte ai, - “tue dashun të bashkoj të gjitha fuqitë e shqiptarëve e t’i drejtoj ndë qëllim të vetëm, qi asht shpëtimi i atdheut”<sup>26</sup>. Bashkimi u arrit më 31 korrik, pavarësisht nga disa rezerva që u shfaqën fillimisht, pikërisht dy ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes italo-greke të 29 korrikut, midis Titonit dhe Venizellos, dhe pasi delegacioni qeveritar pranoi disa propozime të përfaqësuesve të diasporës. Ndër to kërkesat kryesore ishin: 1. Në përbërje të delegacionit të përfshiheshin përsëri dy anëtarët e përjashtuar më 28 qershor d.m.th M.Konica dhe M. Turtulli dhe 2. Përpjekjet më tej në Konferencën e Paqes për mbrojtjen e çështjes shqiptare të paraqiteshin në një program të miratuar bashkërisht.<sup>27</sup>

Nga vendimi me shkrim, që u hartua më 31 korrik, me rastin e bashkimit, dalin bazat politike të programit, por duken edhe lëshimet që të dy grupet i bënin njeri-tjetrit. Gjithsesi pa u zgjatur vërehet se më 31 korrik palët ranë dakord që programi “do të mbështetet gjithnjë mbi parimet e tërësisë tokësore, të pavarësisë dhe të drejtave syperane të kombit shqiptar” dhe mbi këtë bazë do

<sup>24</sup> *AQSH*, Fondi S. Delvina, dos.1. Vendimi dt. 28.04.1919 i kolonisë shqiptare të Turqisë për dërgimin e S.Delvinës në Paris.

<sup>25</sup> *AQSH*, Fondi K. Dako, dos.16, fl.120.

<sup>26</sup> *AQSH*, Fondi P. Qiriazit, dos.14, fl.13. Letra e L. Bumçit, dt.27.07.1919; *po aty*, Fondi P. Evangjeli, dos.8, fl.1. Letra e së njëjtës datë dërguar nga L.Bumçi - P. Evangjelit.

<sup>27</sup> *Po aty*, Fondi K. Dako, dos. 16, fl. 116-123. Letra e P. Qiriazit, dt. 28.07.1919.

të pranohej edhe “asistenca” e ndonjëres prej fuqive aleate, por “që asistenca të jetë e përkohshme e të mos lëndojë të drejtat syperane të shtetit shqiptar as zhvillimin e përparimin e tij ekonomik”<sup>28</sup>.

Ky program u pranua si nga M. Konica, ashtu edhe nga përfaqësuesit e diasporës (kolonive), ku veçanërisht u shquan me veprime konstruktive përfaqësuesit e diasporës P. Evangjeli e P. Qiriazit. Në delegacionin e riformuar, përfaqësuesit e diasporës që ndodheshin në Paris do të luanin pas kësaj kohe një rol më aktiv. Dy prej tyre, P. Evangjeli, përfaqësues i kolonisë së Rumanisë dhe Fuat Zemblaku (Dibra) përfaqësues i kolonisë së Turqisë u caktuan si delegatë të delegacionit qeveritar.<sup>29</sup> Përfaqësuesit e diasporës të ndodhur në Paris më 2 gusht 1919, me anë të një letre dërguar delegacionit qeveritar treguan gatishmërinë për t’u bashkuar rreth tij “për ta ndihmuar këtë në detyrën patriotike.”<sup>30</sup>

Për ndryshimet e reja në delegacionin qeveritar u njoftuan menjëherë edhe organizmat e Konferencës së Paqes. Paskëtaj nuk do t’i dërgoheshin më konferencës nota të veçanta nga të dy fraksionet, sikurse kishte ndodhur prej 14 prillit 1919. Ato do t’i përcilleshin nga delegacioni i bashkuar me në krye L. Bumçin. Po ashtu përfaqësuesit e diasporës nuk do të ndërhyjnë më pranë konferencës me memorandume e shkrime të veçanta sikurse kishte ndodhur që prej 7 marsit 1919. Sidoqoftë, pavarësisht nga veprimet e njësuara të sipërpërmendura, pikëpamjet e ndryshme politike, që kishin të dy grupet midis tyre, lidhur me përballimin e gjendjes kritike në Konferencën e Paqes nuk u mënjanuan, veçanërisht kur ishte fjala për përcaktimin e rrezikut kryesor, nëse këtë e përbënte Italia apo monarkitë fqinje ballkanike, si edhe a i duheshin bërë lëshime Italisë për të “shpëtuar” vendin nga një e keqe më e madhe. Kuptohet që bashkimi i arritur i grupeve ishte një kompromis politik, që nuk i rrafshoi pikëpamjet e ndryshme. Nëse për ata të orientimit proitalian bashkimi qe një fitore e idesë së tyre për të tjerët, përfshi edhe përfaqësuesit e diasporës, bashkimi u pa nga këta, si një mënyrë për të kontrolluar nga brenda veprimtarinë e anëtarëve të delegacionit me orientim italian, që të mos kalonin më tej në lëshime ndaj Italisë. P. Qiriazit vinte në dukje në këtë rast se “tërë shkrimet që do të dërgohen paskëtaj (në konferencë) do të bisedohen prej të gjithëve edhe kështu ka dy a tre veta italo-filë, s’kanë ç’të bëjnë.”<sup>31</sup>

<sup>28</sup> *Lufta e popullit shqiptar...*, vëll.I, dok. 195, f. 292.

<sup>29</sup> *AQSH*, Fondi MPJ, dos. 322. Procesverbali i 31.07.1919.

<sup>30</sup> *AQSH*, Fondi MPJ, dos. 322. Letër e delegatëve të kolonive dërguar L. Bumçit më 2 gusht 1919.

<sup>31</sup> *AQSH*, Fondi K. Dako, dos.16, fl.116-123. Letra e P. Qiriazit e dt. 28.07.1919.

Në këto kushte vijoi lufta politike e diplomatike e delegacionit shqiptar, në 6-mujorin e dytë të vitit 1919, kundër pretendimeve të vendeve fqinje dhe kundër miratimit të këtyre pretendimeve nga përfaqësuesit e tri fuqive kryesore fituese. Lufta e tij kuptohet u përqendrua kundër mandatit italian, që çonte në shkeljen e pavarësisë së Shqipërisë, si edhe, veçanërisht, kundër copëtimit të mëtejshëm të trojeve shqiptare, që çonin në ndarjen midis fqinjëve të disa territoreve të përfshira më 1913 në kufijtë e shtetit shqiptar.

Në të gjithë këtë proces kontributi i përfaqësuesve të diasporës apo i kolonive ishte i dukshëm. Përfaqësuesit atdhetarë të diasporës shqiptare, sikurse dëshmojnë materiale të ndryshme të kohës, edhe njëherë në këtë moment crucial, do të ishin në vijën e parë të përpjekjeve për ringritjen dhe konsolidimin e shtetit shqiptar, sikurse kishin qenë edhe në dekadat e mëparshme dhe në momentet e Shpalljes së Pavarësisë.

Marrëveshja Titoni-Venizello e 29 korrikut, e pasuar nga marrëveshja kapitulluese midis qeverisë së Durrësit dhe qeverisë italiane e 20 gushtit, miratimi nga Fuqitë, përfshi edhe ShBA i mandatit italian mbi shtetin shqiptar ishin tërmete që tronditën rëndë përfaqësuesit shqiptarë në Paris, veçanërisht grupin që rrezik kryesor konsideronte politikën italiane ndaj Shqipërisë, si edhe përfaqësuesit e diasporës që kishin të njëjtin qëndrim.

Me këtë rast pati prishje të busullës edhe për delegatët e diasporës nga ShBA-ja. Vetë delegatët e ShBA-së i tronditën përfaqësuesit shqiptarë, kur më 17 dhe 18 shtator i këshilluan “se gjëja më e mirë ishte jo të këmbëngulnin për “asistencën” e ShBA-së por “të pranonin proteksionin italian” mbasi Italia ishte “një mike e mirë e Shqipërisë”<sup>32</sup>.

Në mbledhjet e 30 shtatorit dhe të 7 tetorit nga përfaqësuesit e diasporës pati zëra që të mbështetjet qëndrimi i delegacionit qeveritar për të pranuar “asistencën” italiane<sup>33\*</sup>. Të tillë qenë Dh. Berati (Rumani) dhe M. Shani

<sup>32</sup> *PRFR of the USA*, PPC, Vol.I, XI, f. 423.

<sup>33</sup> \* Në këtë kohë përfaqësitë e kolonive të diasporës kishin ndryshime krahasuar me mars-prillin e 1919-ës. Ishin larguar nga Parisi dr. Ibrahim Temo, princi Albert Gjika, Vangjel Goxhomani dhe përfaqësia e kolonisë së Rumanisë përbëhej vetëm nga Pandeli Evangjeli dhe Dhimitër Berati që kishte ardhur kohët e fundit. Përfaqësia e “Partisë Politike” të SHBA përbëhej nga Parashqevi Qiriazzi, Nuredin Vlora dhe Nikolla Ivanaj. Ky i fundit kishte ardhur nga Shkodra në muajin gusht, kurse Mihal Grameno ishte kthyer në SHBA. Vetëm përfaqësia e kolonisë shqiptare të Turqisë kishte pësuar pak ndryshime dhe vijonte të kishte numrin më të madh të anëtarëve. Ishte larguar I. Bonati, por me vajtjen në Paris të Sulejman Delvinës, ajo përbëhej po nga 5 anëtarë dhe vazhdonte të ishte nga më aktivët. Katër anëtarët e tjerë ishin: Halil Gjirokastra (Alizoti), Benedikt Blinishti, Fuat Dibra (Zëmlaku), Mihal Shani (Tepelena).

(Turqi). Por, në dy mbledhje të organizuara pjesa më e madhe e përfaqësuesve të diasporës shfaqti për herë të parë mendimin se çështja e pavarësisë duhej ndarë nga ajo e asistencës dhe para konferencës duhej dalë vetëm me kërkesën për pavarësinë e plotë të Shqipërisë dhe duhej hedhur poshtë jo vetëm mandati italian por edhe “asistenca” italiane<sup>34</sup>. Shkoqur këtë pikëpamje e shprehu delegacioni i kolonisë shqiptare të Turqisë, duke e paraqitur me shkrim L. Bumçit më 8 tetor.

Por delegacioni i qeverisë së Durrësit qëndroi në pozitën e pranimit të “asistencës” italiane. Me këtë rast përfaqësuesit e diasporës u distancuan nga delegacioni i qeverisë së Durrësit por edhe nga M. Turtulli, M. Konica dhe M. Frashëri, që tani së fundi kishin pranuar “ndihmën” italiane dhe praninë e një princi italian në fronin shqiptar.

Përfaqësuesit e diasporës u pozicionuan në shtator-tetor 1919, sikurse që deklaruar edhe Komiteti MKK që në shkurt, kur përmes gazetës “Populli” kishte deklaruar se as “organizatorë e kontrollorë të huaj” për administratën dhe as “ushtri e huaj” për të siguruar vendin nuk i duhej Shqipërisë. “Shqipëria ka me u vu e do të vihet në rregull vetëm prej nesh. Shqipërinë kan me e drejtue e duhet ta drejtojnë shqiptarët”.<sup>35</sup>

Përpjekjet e delegacionit shqiptar gjatë muajve shtator-dhjetor 1919, për të gjetur kompromise për problemet që sillnin pretendimet e fqinjëve dhe qëndrimi i Fuqive të Mëdha dëshmojnë jo vetëm pafuqinë e delegacionit shqiptar, por edhe të faktorit shqiptar në përgjithësi përballë frymës me të cilën po trajtohej në Konferencën e Paqes, çështja shqiptare.

Memorandumi i njohur i 9 dhjetorit 1919 i firmosur nga ShBA-ja, Anglia dhe Franca, që i njëjtte Italisë sovranitetin mbi Vlorën e krahinën përreth dhe mandatin mbi Shqipërinë Qendrore i njëjtte Greqisë aneksimin në mos të dy trevat e Shqipërisë Jugore, patjetër njëri prej tyre, Gjyrokastër duke cenuar rëndë tërësinë tokësore të Shqipërisë.

Zbatimi i tij ishte katastrofë, por e keqja thellohej më tej me Kompromisin e 13-14 janarit 1920. Italisë i garantohej nga Anglia dhe Franca, Vlora dhe mandati mbi Shqipërinë, që njëherësh humbiste Gjyrokastër dhe Korçën, të cilat i ofroheshin Greqisë. Në këto rrethana mbetej të zgjidhej çfarë do të përfitonte Jugosllavia, që s’mund të lihej pa pjesë.

<sup>34</sup> AQSH, Fondi MPJ, dos. 322; shih edhe *Lufta e popullit shqiptar...*, vëll.I, dok. 267 dhe 272.

<sup>35</sup> Gazeta *Populli*, Shkodër, 14.02.1919. Artikulli “A ka me u ba e si ka me u rregullue Shqipëria?”

Delegacioni i qeverisë së Durrësit, kur çështja ziente, iu drejtua me letra më 9 dhe 10 janar F. Nitit dhe Zh. Klemansonit<sup>36</sup>. Më 12 janar në kryesinë e Konferencës vërshuan protesta nga Shqipëria dhe diaspora. Në protestën e Komitetit MKK thuhej: "... protestojmë fuqimisht kundër kësaj padrejtësie".... dhe, nëse ndodh ky "akti shëmtuar politik"...., shqiptarët do të luftonin, "gjersa të mos mbetej asnjë i gjallë..."<sup>37</sup>

Reagimi më 12 janar erdhi edhe nga përfaqësuesit e diasporës shqiptare në ShBA. "Partia Politike" në protestën dërguar Klemansonit, theksonte se, "nëse nuk hiqet dorë nga ky projekt, kombi shqiptar do të luftojë deri në fund për tërësinë tokësore dhe pavarësinë e plotë të atdheut"<sup>38</sup>.

Ndërkohë delegatët e diasporës shqiptare të Turqisë dhe Rumanisë e përqendruan presionin e tyre edhe mbi delegacionin e qeverisë së Durrësit, që kishte kapitulluar dhe nuk shihte zgjidhje tjetër veç lëshimeve<sup>39</sup>.

Në një kohë kur Shqipëria politike, shteti i pavarur i njohur më 1913, rrezikohej të zhdukej, kuptohej se të kërkojë korrigjim të kufijve të cunguar ishte absurditet. Mërgata shqiptare, ku një vend parësor të padiskutueshëm zinte Komiteti MKK si edhe diaspora shqiptare në botë e kuptonte se së pari duhej shpëtuar shteti shqiptar. Pa u shpëtuar ai nuk mund të pretendohet të shpëtonte Kosova dhe viset e tjera të copëtuara më 1913.

Edhe përfaqësuesve nga viset e copëtuara iu digjej zemra për trevat e të parëve të tyre, por me pjekuri maksimale, përgjithësisht, me ndonjë përjashtim ditën të kuptojnë e vlerësojnë situatën, ditën të mbajnë qëndrimin e duhur dhe, duke bërë ç'mund të bëhej në viset në robëri për të ruajtur atje fizikisht dhe shpirtërisht shqiptarinë, kombin shqiptar kontribuuan për të përgatitur çlirimin e tyre në të ardhmen.

Shembujt janë të shumtë. Përfaqësuesit e Komitetit MKK mbështetën Kongresin e Lushnjës (21-31 janar 1920), Kryetari i Komitetit Hoxha Kadri Prishtina u zgjodh nga Kongresi ministër në qeverinë që doli nga ky tubim i madh patriotik. Njëherësh Komiteti MKK propagandoi çështjen e Kosovës në Evropë dhe organizoi qëndresën shumëformëshe në Kosovë e më gjerë kundër autoriteteve serbe në ato vise, deri në rezistencën me armë. Luftëtarët

<sup>36</sup> AQSH, Fondi MPJ, dos.6 (26); shih edhe *Lufta e popullit shqiptar...*, vëll.II, dok.19, fl. 31-32.

<sup>37</sup> AQSH, Fondi MKK, dos. 31. Protestë e Komitetit MKK, dt. 12 janar 1920.

<sup>38</sup> AQSH, Fondi "P. Qiriazi". Protestë e organizatës së shqiptarëve në SHBA, dërguar Zh. Klemanson më 12 janar 1920.

<sup>39</sup> AQSH, Fondi MPJ, dos.2. Letër e përfaqësuesve të kolonive të Turqisë e Rumanisë, dt. 12 janar 1920.

e çetave të atyre viseve ishin aktivë, sikurse trimat e Isa Boletinit në vitet 1912-1913, në mbrojtje të Shqipërisë, në Shqipërinë e Mesme, në Kopluk, në Dibër apo Mirditë. Bajram Curri me luftëtarë të malësive e të Kosovës, shpartalloi esadistët disa muaj pas Kongresit dhe më pas rebelimin e nxitur e mbështetur nga Beogradi, të Kapidanit të Mirditës.

Në krye të qeverisë të dalë nga Kongresi i Lushnjës dhe njëherësh mbështetës real i Luftës fitimtare të Vlorës, që largoi nga Vlora e Shqipëria trupat italiane të pushtimit ishte një përfaqësues i diasporës, pikërisht Sulejman Delvina.

Në detyra të ndryshme të rëndësishme në këto vite të pasluftës botërore, ishin aq të shumtë përfaqësuesit e diasporës shqiptare, sa që mund të thuhet pa mëdyshje, se, sikurse në periudhën e Rilindjes Kombëtare dhe në vitet e para të shtetit të pavarur shqiptar, diaspora që fuzioni me elementin atdhetar dinamik, me arsimim e përvojë shumë më të madhe se mesatarja e elitës brenda vendit, që kontribuoi në ringjalljen e Shqipërisë.

Përfaqësuesit e diasporës dhe mërgatës ditën të vlerësojnë se ku duhej me përparësi në vitet 1919-1920 të përqendrohej goditja dhe u bashkuan me idenë që të shpëtohej, së pari, shteti shqiptar, duke punuar njëherësh, sa edhe si ishte e mundur, për të garantuar në perspektivën, sado të largët, çlirimin e Kosovës dhe viseve të tjera të copëtuara.

Kështu mërgata e viteve 1918-1920 dhe diaspora shqiptare e kësaj kohe, veçanërisht e kolonive në ShBA, Turqi e Rumani, dhanë kontribut të jashtëzakonshëm si në ringjalljen e Shqipërisë së pavarur, ashtu edhe në hedhjen e themeleve për përgatitjen e perspektivës së sigurt për gjeneratat e reja të asaj pjese të kombit që mbeti në territoret e lëna arbitrarisht nën sundimin e huaj.